



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I QARKUT KORÇË**

**VENDIM**

**Nr. 17 datë 31/10/2022**

**Mbi lidhjen e Marrëveshjes së bashkëpunimit midit Këshillit të Qarkut Korçë dhe Bashkisë Pogradec për projektin “Pastrimi i bregut të Liqenit”**

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin Nr. 30 datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, Ligjit 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, Këshilli i Qarkut Korçë mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Bashkia Pogradec për lidhjen e një Marrëveshje bashkëpunimi për projektin “Pastrimi i bregut të Liqenit”. U konstatua se është një projekt i cili ka për qëllim të përmirësojë kushtet e komunitetit, përmes pastrimit të bregut nga papastërtitë dhe mbetjet e grumbulluara duke shmangur edhe problematikat e ndryshme me të cilat përballësin banorët por edhe turistët e ardhur që preferojnë liqenin e Pogradecit. Në këto kushte duke vlerësuar impaktin pozitiv që do të ketë në ambjent por edhe tek komuniteti ky projekt, dhe pas diskutimeve të këshilltarëve:

**VENDOSI:**

1. Të autorizojë lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit midit Këshillit të Qarkut Korçë dhe Bashkisë Pogradec për projektin “Pastrimi i bregut të Liqenit”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerëzore dhe zhvillimit të territorit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT**

**ANA VERUSHI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I QARKUT KORÇË

### RELACION

#### **“Mbi lidhjen e Marrëveshjes së bashkëpunimit midit Këshillit të Qarkut Korçë dhe Bashkisë Pogradec për projektin “Pastrimi i bregut të Liqenit”**

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin Nr. 30 datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, Ligjit 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, Këshilli i Qarkut Korçë mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Bashkia Pogradec për lidhjen e një Marrëveshje bashkëpunimi për projektin “Pastrimi i bregut të Liqenit”.

Projekti “Pastrimi i bregut të Liqenit”, parashikon pastrimin e pjesës së plazhit në zonën urbane të qytetit të Pogradecit si dhe Plazhi që shtrihet përgjatë bregut të liqenit në Njesinë Administrative Bucimas, në fshatrat Bucimas dhe Tushemisht. Projekti ka për qëllim të përmirësojë kushtet e komunitetit, përmes pastrimit të bregut nga papastërtitë dhe mbetjet e grumbulluara duke shmangur edhe problematikat e ndryshme me të cilat përballeshin banorët por edhe turistët e ardhur që preferojnë liqenin e Pogradecit.

Koncepti kryesor i ndërhyrjes për Bregun e plazhit është ndërimi i një plazhi publik uniform, të dallueshëm dhe të vazhdueshëm duke krijuar mundësi të reja për zhvillimin e zones turistike që mbulon ky plazh.

Për këtë qëllim, është e rëndësishme të përmbysset situata aktuale e bregut të liqenit ku gjendja aktuale le shume vend për përmirësime. Për këtë është e rëndësishme t'i jepet përparësi pastrimit dhe rikualifikimit të këtij plazhi.

Në disa pika ka depozitim të mbetjeve bujqesore të parcelave që shtrihen përgjatë bregut duke krijuar një pamje aspak të këndshme për zhvillimin turistik që duam të japim kësaj zone. Vitet e fundit është vënë re një rritje e dukshme e numrit të turistëve që kanë vizituar dhe pushojnë në qytetin tonë. Ndaj ky projekt është shumë i rëndësishëm për të dhënë një shtytje të re zhvillimit të turizmit. Në këto kushte duke vlerësuar impaktin pozitiv që do të ketë në ambient por edhe tek komuniteti ky projekt, por edhe në vijim dhe mbështetje të politikave të ndjekura nga qeverisja qendrore në lidhje me mjedisin vlerësojmë si të nevojshëm dhe shumë efikas këtë projekt.

Referuar nenit 14 të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" kërkojmë nga Këshilli i Qarkut Korçë autorizimin për lidhjen e Marrëveshje bashkëpunimi me Bashkia Pogradec për projektin "Pastrimi i bregut të Liqenit", për pastrimim e pjesës së plazhit në zonën urbane të qytetit të Pogradecit si dhe Plazhi që shtrihet përgjatë bregut të liqenit në Njesinë Administrative Bucimas, në fshatrat Bucimas dhe Tushemisht.

Konceptoi Gj. Kristo

